

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë (1) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më 12 janar 2022, duke filluar nga ora 09:00, me këtë:

REND DITE

1. Zgjedhja e nënkryetarit nga komuniteti joshumicë i komunës së Dragashit

z.Uran Halimi – Përshëndetje, të nderuar delegatë, z.kryetar dhe të gjithë të pranishëm. Po e hapi seancën e parë të KPF-së për këtë vit kalendarik, në këtë mandat, gjatë së cilës i përgëzoj të gjithë për pozitën e reja. Ne kemi vetëm një pikë në rendin e ditës të kësaj mbledhje të Komitetit. Zgjedhja e nënkryetarit të komunës nga radhët e komuniteteve joshumicë të komunës së Dragashit. Ftoj kryetarin që të na propozojë një kandidat për nënkryetar nga komuniteti joshumicë i komunës së Dragashit.

z.Bexhet Xheladini – Përshëndetje të gjithëve, ju uroj punë të mbarë anëtarëve në këtë takim të parë të KPF-së, ju uroj suksese dhe shëndet. Bazuar në kompetencat nga LVL-së nr.03-L-040, si dhe në bazë të UA 02/2020 MAPL për procedurën e emërimit të nënkryetarëve të komunave, sot në rend dite kemi zgjedhjen e nënkryetarit për komunitete të komunës së Dragashit dhe duke u bazuar në të gjitha këto, si Kryetar i Komunës, propozoj si kandidat të mundshëm Munezir Kukën nga fshati Restelicë. Ju faleminderit.

z.Artan Loshaj - Përshëndetje të gjithëve, meqenëse është seanca e parë dhe ju uroj të gjithëve punë të mbarë, një vërejtje miqësore për kryesuesin, sipas rregullave duhet të kishit hedhur në votim fillimisht rendin e ditës dhe nëse mund të kemi propozim për disa pika të tjera të rendit të ditës. Sot doja të propozoja një pikë “Eventuale”, ndoshta, sepse kemi 4 seanca që nuk kemi këtë pikë në rend të ditës. Qytetarët na votuan dhe mezi presin të na dëgjojnë, këtu janë problemet e tyre dhe gjërat për tu diskutuar. Dhe nëse ka mundësi që kryetari të na shpjegojë se kush është ky njeri, shkollimin, përkatësinë, nga vjen, nga cila parti e të ngjashme, sepse nuk kemi informacion të mjaftueshëm për kandidatin.

z.Uran Halimi – Nuk e kemi parashikuar pikën “Eventuale” ndoshta sepse kjo është seanca e parë e KPF-së dhe kemi vetëm një pikë në rend dite. Këto pika sigurisht që do t'i kemi më vonë. Sa i përket kandidatis, besoj se kryetari nesër në kuvend do të shpjegojë më hollësisht se kush

është kandidati i tij si dhe përkatësinë e tij, pra biografinë e tij. Nëse askush tjetër nuk ka diçka për të shtuar, atëherë ne mund ta mbyllim seancën e komitetit tonë të parë.

z.Artan Loshaj – Mos e keni problem, pika e rendit të ditës, kur vihet në votim, aty e keni zyrtarin ligjor, për çdo pikë të rendit të ditës duhet votuar fillimisht në komitet, sepse komiteti është i zgjedhur nga ana e Kuvendit, ne e luajmë rolin e Kuvendit. Çdo pikë duhet të vijë, se nëse jemi dakord me të apo jo. Pra, çdo pikë duhet së pari të vihet në votim këtu në këtë komitet. KPF-ja dhe pjesëtarët e saj duhet të dinë se cili është obligimi dhe detyra e tyre. Çdo propozim këtu votohet që ne si komitet të pajtohemi që ta përcjellim për në Kuvend.

z.Uran Halimi – A jeni dakord që të hidhet në votim që kjo pikë të jetë në rendin e ditës të Kuvendit të nesërm. Kush është PRO-5, KUNDËR-2, ABSTENIM-0. Kjo do të thotë se pika miratohet dhe përcillet në Kuvend për shqyrtim të mëtejshëm. Nëse nuk ka diskutues të tjerë, mbyll seancën e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa. Ju faleminderit.

Përgatiti:

Shërbimi i KK-së Dragash

Kryesuesi i seancës:

Uran Halimi